



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d) dhe 17 shkronja a) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, neneve 14, 15 paragrafi 2.4 dhe 19 paragrafi 1.1 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 31 janar 2020, miratoi,

VENDIM PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË PËR ZHVILLIM EKONOMIK LOKAL TË KOMUNËS SË PODUJEVËS PËR PERIUdhËN 2020 – 2022

Neni 1

Miratohet Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal – SZHEL e Komunës së Podujevës për periudhën 2020 – 2022.

Neni 2

Strategjia, ndër të tjera, përcakton vizionin, misionin, qëllimet strategjike si dhe gjitha çështjet tjera relevante për Komunën e Podujevës në funksion të zhvillimit ekonomik lokal për periudhën 2020 – 2022.

Neni 3

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal për periudhën 2020 - 2022.

Neni 4

Nën përkujdesjen e Kryetarit të Komunës, zbatimin e vendimit e bëjnë Drejtoritë Komunale.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 parag. 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave.

Nr.01-300/02-0007424/20
Podujevë,
31 janar 2020



Kryesuesi i Kuvendit
Fatmir Gashi